

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarve F. B., nga fshati Gj., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale mbikëqyrja e padëngjergjshme e trafikut publik nga neni 300 par. 5 lidhur me par. 3 dhe 2 të KPK-së, i akuzuari E. Ç., nga fshati P., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par. 5 lidhur me par. 3 dhe 1 të KPK-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr. 252/2008 të datës 09.01.2009, pas mbajtjes së seancës kryesore publike në praninë e Prokurores të shtetit në Prizren Beqë Shala, të akuzuarve, me date 19.07.2016 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.F. B., nga i ati A., dhe e ëma F., e lindur C., i lindur më *data e lindjes...* në fshatin Gj., Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, i martuar, i ati gjashtë fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion ndërtimtar – pronar i Ndërmarrjes “F.-C.” në fshatin Gj., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

2.E. Ç., nga i ati B., dhe ëma Xh., e lindur S., i lindur më *data e lindjes...* në P., Komuna e Prizrenit, tani me banim në Prizren, në rrugën ... nr...., i martuar, i ati i dy fëmijëve, punëtor në ndërtimtari, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në paraburgim nga data 24.10. gjerë më 24.11.2008.

JANË FAJTOR

1.I akuzuari: F. B.

Se me datë 24.10.2008 rreth orës 08:30 minuta në cilësi të personit përgjegjës – pronar i Ndërmarrjes “F.-C.” me seli në fshatin Gj., Komuna e Prizrenit, lejon vozitësin e Ndërmarrjes E. Ç. që me automjetin e Ndërmarrjes të tipit “Passat” me nr. të regjistrimit *numri i targës...* të cilit kishte bashkangjitur edhe një rimorkio të paregjistruar dhe teknikisht të pakontrolluar, të qarkullojë në rrugë publike me ç’rast në fshatin L. për shkak se rimorkio nuk ishte në gjendje të rregullt teknike shkëputet nga automjeti, del jashtë rrugës dhe e godet të ndjerin S. Sh., fëmijë nga fshati L. i lindur në vitin 2003 që si pasojë i ndjeri vdes rrugës për në spitalin e Prizrenit.

Këso dore ka kryer vepër penale mbikëqyrja e padëngjergjshme e trafikut publik nga neni 300 par. 5 lidhur me par. 3 dhe 2 të KPK-së.

2.I akuzuari: E. Ç.

Se me datë 24.10.2008 rreth orës 08:30 minuta në rrugën rajonale në fshatin L. të H., rrezikon trafikun publik dhe jetën e njerëzve dhe shkakton vdekjen e tani të ndjerit S. Sh. nga fshati L., fëmijë e lindur në vitin 2003, në atë mënyrë që duke e drejtuar automjetin e udhëtarëve të tipit “Passat” me nr. të regjistrimit *numri i targës...* vozit me një shpejtësi më të madhe se shpejtësia e lejuar për atë pjesë të rrugës, i vetëdijshëm se me një veprim të tillë mund të shkaktohet pasoja e ndaluar, lehtas merre gjerë te ajo nuk do të vijë, apo edhe nëse vjen do ta mund ta evitojë gjer te e cila ka ardhur, kur në një moment rimorkio shkëputet nga automjeti, del jashtë rrugës dhe godet të ndjerin dhe si pasojë e kësaj goditje ai vdes rrugës për në spitalin e Prizrenit.

Këso dore ka kryer vepër penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par. 5 lidhur me par. 3 dhe 1 të KPK-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 73 të KPK-ës, te akuzuarve ju shqipton:

DENIM ME KUSHT

Të akuzuarit të parë A. K.,

Ashtu që i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 3 (tre) viteve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale.

Të akuzuarit të dytë A. M.,

Ashtu që i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 3 (tre) viteve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale.

Të akuzuarit të tretë I. M.,

Ashtu që i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 3 (tre) viteve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale.

I dëmtuari N. R. T., nga fshati S., Komuna e Podujevës, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohen të akuzuarit që të paguajnë në mënyrë solidare shpenzimet gjyqësore dhe ate në emër të mendimit të ekspertit mjeko ligjor shumë prej 20,44 euro, si dhe të paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 20,00 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr. 926/2011 të datës 29.04.2011, kundër të akuzuarve A. K., A. M., dhe I. M., të gjithë nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par.1 nën par.3 të KPK-ës,

Prokurorja e shtetit Mehreme Hoxa në fjalën e saj përfundimtare deklaron: mbes në tërësi pran aktakuzës PP.nr.926/2011 të datë 29.04.2011 të parashtruar ndaj të pandehur A. K., A. M. dhe I. M., të gjithë nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor në bashkëveprim nga neni 154 par.1 nën par.3 të KPK-ës, e tërë kjo ngase në shqyrtimin e sotëm gjyqësor në tërësi u vërtetua gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, e kjo nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve, të cilët në mënyrë vullnetare e pranuan fajësinë për veprën penale e cila ju vihet në barë, si dhe në bazë të provave tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Andaj propozoj gjykatës që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit, paraprakisht duke i mare për bazë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

I akuzuari i parë A. K. në fjalën e tij përfundimtare deklaron: më vije keq për tërë këtë që ka ndodhur, unë së bashku me dy kolegët e mi A. M. dhe I. M. kemi qenë në vendin tonë të punës, pasi që e pranoj fajësinë ndaj këtu të dëmtuarit e marr përsipër edhe përgjegjësin juridike për veprën penale të shkaktuar. Por, i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ate pranimin e fajësisë, që kam qenë në vende të punës, kam qenë pakës i provokuar edhe me sjelljet dhe fjalët e të dëmtuarit, andaj të gjitha këto të cekura si dhe rrethanat tjera lehtësuese që i gjen gjykata ti merr parasysh me rastin e marrjes së vendimit.

I akuzuari i dytë A. M. në fjalën e tij përfundimtare deklaron: më vije keq për tërë këtë që ka ndodhur, unë së bashku me dy kolegët e mi A. K. dhe I. M. kemi qenë në vendin tonë të punës, pasi që e pranoj fajësinë ndaj këtu të dëmtuarit e marr përsipër edhe përgjegjësin juridike për veprën penale të shkaktuar. Por, i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ate pranimin e fajësisë, që kam qenë në vende të punës, kam qenë pakës i provokuar edhe me sjelljet dhe fjalët e të dëmtuarit, andaj të gjitha këto të cekura si dhe rrethanat tjera lehtësuese që i gjen gjykata ti merr parasysh me rastin e marrjes së vendimit.

I akuzuari i tretë I. M. në fjalën e tij përfundimtare deklaron: më vije keq për tërë këtë që ka ndodhur, unë së bashku me dy kolegët e mi A. M. dhe A. K. kemi qenë në vendin tonë të punës, pasi që e pranoj fajësinë ndaj këtu të dëmtuarit e marr përsipër edhe përgjegjësin juridike për veprën penale të shkaktuar. Por, i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ate pranimin e fajësisë, që kam qenë në vende të punës, kam qenë pakës i provokuar edhe me sjelljet dhe fjalët e të dëmtuarit, andaj të gjitha këto të cekura si dhe rrethanat tjera lehtësuese që i gjen gjykata ti merr parasysh me rastin e marrjes së vendimit.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datën 26.01.2011, rreth orës 15,00 minuta, në bashkëveprim në Prizren, në rrugën ..., në auto parkingun e kompanisë "V.", i shkaktojnë lëndime të rënda trupore personit tjetër duke dobësuar përkohësisht një pjesë vitale të trupit, në atë mënyrë që pas një zënke në lidhje me

automjetin e të dëmtuarit N. T., ku kohë më parë me urdhër të policisë ishte tërhequr me marimangë nga ana e kompanisë së lartë përmendur, të akuzuarit e sulmojnë fizikisht, duke e goditur me grushta dhe shkelma në pjesë të ndryshme të trupit, me të cilin rast i shkaktojnë lëndime të rënda trupore dhe ate në hundë, ku klasifikohen në plagë shqyese – pëlçitëse të shoqëruara me thyerje të kockave të hundës, të cilat lëndime më për së afërmi janë të përshkruar në mendimin e ekspertit mjeko ligjor dr. C. M., të datës 11.03.2011.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve të cilët në shqyrtimin kryesor vullnetarisht kanë pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila ju vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me neni 248 të KPPK-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 154 paragrafi 1 nën paragraf 3 të KPK-ës.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, pendimi i thellë i të akuzuarve, i tërë rasti lidhur me këtë çështje penale ka ndodhur në vendin e punës të akuzuarve, ka pasur edhe një provokim sipas të akuzuarve nga fjalët e të dëmtuarit, të akuzuarit janë persona familjar, prindër të fëmijëve dhe ate i akuzuari i parë A. K. dhe i akuzuari i tretë I. M. baba të katër fëmijëve, ndërsa i akuzuari i dytë baba i tre fëmijëve, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, gjerë më tani të pa gjykuar, çka nënkupton se nuk kanë ardhur ndesh me rregullat pozitive, andaj gjykata ju shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim secilit të akuzuar veç e veç në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 3 (tre) viteve, të akuzuarit nuk kryejnë veprë të re penale, duke menduar se dënim i shqiptuar ju përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tyre dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPPK.

Vendimin mbi kërkesën pronësorë juridike u muar në kuptim të nenit 463 KPPK-ës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1121/2011 të datës 20.09.2013

Procesmbajtësja
Naxhis Sharani

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.